



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 44 prot.

Kamëz, më 25.6.2025

V E N D I M
Nr. 37.Datë 25/6 2025
MBI

“SHPREHJEN E PËLQIMIT NË PARIM MBI KËRKESËN NR.2945/12 PROT., DATË 29.05.2025 TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.06.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.32 Datë 17.06.2025 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, nenit 54 pika e/1, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.01.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; VKM-së nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të VKM-së nr.28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, VKM-së nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi osë në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë” dhe Shkresës nr. 2945/12 prot., datë 29.05.2025, me lëndë: “Kërkojmë miratimin në lidhje me disa pasuri”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim mbi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vazhdimin e procedurave me organet kompetente, për transferimin pranë kësaj ministrie, të pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Kamëz, me VKM-në nr.775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi osë në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë” dhe me VKM-në 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujëties dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, duke ju nënshtruar një trajtimi të kujdesshëm me qëllim që të mos cënohet funksionaliteti i tyre, *për pasuritë si më poshtë:*
 - Pasurisë nr.254, ZK.2066, të llojit “Rrugë” si dhe segmentit të kanalit kullues që shtrihet paralelisht me rrugën, pjesë e skemës së kullimit K.K.13, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
 - Pasurisë nr.270, ZK.2066 e llojit “Rrugë” si dhe segmentit të kanalit kullues që shtrihet paralelisht me rrugën, pjesë e skemës së kullimit K.K.II, sipas planvendosjes bashkëlidhur.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

2. Pasuritë sipas pikës 1, të hiqen nga Inventari i Bashkisë Kamëz dhe të transferohen pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për këto pasuri.
3. Pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për këto pasuri, ngarkohen për zbatim Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave & Menaxhimit të Aseteve të Bashkisë Kamëz, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas ~~konfirmimit ligjor nga~~ **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI**

